



NGROHTORJA E QYTETIT GJAKOVA SH.A.
DISTRICT HEATING GJAKOVA J.S.C.
GRADSKA TOPLANA GJAKOVICA D.D.
380
Nr. 22.09.2021
Dm. GJAKOVA - GJAKOVA - DJAKOVICA

Republika e Kosovës - Republika Kosova
Komuna e Gjakovës - Opština Djakovica
Drejtoria për Punë të Përgjithshme Administrativë
Uprava za Opštë, Administrativne Poslove
P1 Nr./Br. 913/01-28076
Data/Datum 23.09.2021
Gjakovë-Djakovica-Gjakova

Memorandum i Mirëkuptimit

Ndërmjet

Agjencia Pyjore e Kosovës

Adresa: Rr. Hamdi Mramori nr. 10
10000 Prishtinë,
Republika e Kosovës

REPUBLICA FEDERATIVA KOSOVA, REPUBLIC OF KOSOVO
MINISTRIA E BUJCESESE, PYLITARISË DHE ZHILIJET PIRAL
MINISTARSTVO PO VJEĆESE, PREDSTAVNIŠTVA I PUBLIKOG RAZVOJA
MINISTRY OF AGRICULTURE, FORESTRY AND RURAL DEVELOPMENT
AGJENCIJA PYJORE E KOSOVËS, AGJENCIJA ZA ŠUME KOSOVA, KOSOVO FOREST AGENCY
Arhive - Arhive - Archive
3752
Nr./Br./No. _____
Nr./f/q/Br./no./No./pg. _____
Data/Datum/Date: 22.09.2021
Prishtinë /a/

dhe

Komuna e Gjakovës

Adresa: Rr. UÇK, nr. 53
50000 Gjakovë,
Republika e Kosovës

dhe

N.P. Ngrohtorja e Qytetit Sh.A

Adresa: Rr. Tirana p.n.
50000 Gjakovë,
Republika e Kosovës

Shtator 2021

Neni 1

Përkuftizimet

1. Përkuftizimet e përdorura :
 - 1.1. KGj – Komuna e Gjakovës;
 - 1.2. NjKP – Njësia Komunale e Pylltarisë, Gjakovë;
 - 1.3. APK- Agjencia Pyjore e Kosovës;
 - 1.4. NQ- Ngrohtorja e Qytetit, Gjakovë Sh.A;
 - 1.5. GIZ - Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit;
 - 1.6. SKZH-2 Strategjia Kombëtare e Zhvillimit;
 - 1.7. PKVER- Plani Kombëtar i Veprimit për Energjinë e Ripërtëritshme;
 - 1.8. PVMP- Plani Vjetor i Menaxhimit me Pyje;
 - 1.9. NjM- Njësia Menaxhuese;
 - 1.10. DKR – Drejtoria Koordinuese Regionale;

Neni 2

Palët

Ky Memorandum është hartuar ndërmjet:

Agjencia Pyjore e Kosovës
Adresa: Rr. Hamdi Mramori Nr.10
10000 Prishtinë, Kosovë;

dhe

Komuna e Gjakovës
Adresa: Rruga UÇK, nr. 53
50000 Gjakovë,
Republika e Kosovës

dhe

Ngrohtorja e Qytetit Sh.A
Adresa: Rr. Tirana p.n.
50000 Gjakovë,
Republika e Kosovës

Neni 3

Baza dhe qëllimi i Memorandumit

1. Baza e këtij Memorandumi të Mirëkuptimit është, Ligji për Pyjet e Kosovës, aktet ligjore dhe nënligjore, Plani Vjetor i Menaxhimit me Pyje për vitin 2021, si dhe projekti i trajtimit të pyjeve të reja në Njësinë Komunale të pylltarisë të komunës së Gjakovës, (DKR Pejë), i cili do të implementohet në Njësinë Menaxhuese “Pashtriku”, ku përfshihen ngastrat pyjore, të cilët do të evidentohen në programin për trajtimin e pyjeve të reja. Realizmi i këtij projekti do të fillojë nga mesi muajit gusht deri në fund të dhjetorit 2021.
2. Qëllimi i këtij Memorandumi, është trajtimi i pyjeve të reja nëpërmjet prerjeve kulturore, kujdesi ndaj grumbullit pyjor, si dhe sigurimi i mbështetjes të Ngrohtores së Qytetit të Gjakovës përmes projektit të trajtimit të pyjeve të reja, me qëllim të:
 1. Trajtimi i pyjeve të reja, prerjeve kulturore nëpërmjet rrallimeve para tregtare, pastrimeve, çlirimeve, të cilat janë me interes për krijimin e grumbujve të së ardhmes, dhe rritjen e vlerës ekonomike të pyjeve në NjM “Pashtriku”, (ky trajtim është planifikuar, edhe në PVMP 2021 të APK), duke pasur parasysh që ka një sipërfaqe të madhe të dominuar nga pyjet e reja, duke synuar në:
 2. Trajtimin e pyjeve të reja, nëpërmjet trajtimeve silvikulturore.
 3. Përzgjedhjen dhe rregullimin e përpjesëtimit të specieve\ekzemplarëve më të mirë për të ardhmen, në ngastrat ku do të realizohet trajtimi, do të bëhet përzgjedhja e drurëve të së ardhmes, dhe krijimi i hapësirave për zhvillim më cilësorë të drunjëve të mbetur.
 4. Nëpërmjet trajtimit të pyjeve të reja, do të nxjerrët masë drusore, (që kryesisht janë drurë me diametër deri në 7 cm), që përbijnë biomasën për prodhim të energjisë se ri përtëritshme (SKZH 2016-2021 dhe PKVER 2011-2020), përfurnizim të NQ .
 5. Trajtimi i pyjeve të reja, nga ku do të rrjedh biomasa planifikohet të jetë në sipërfaqe prej 500 ha, (pjesë e NjM “Pashtriku”), dhe detajet për sipërfaqen e planifikuar për trajtim do të paraqiten në Programin për trajtimin e pyjeve të reja i cili do të hartohet .
 6. Ndikimit të uljes së pa punësisë në zonat rurale në periudhë afatshkurtër. Po ashtu trajtimi i pyjeve të reja, pastrimi i drurëve të mbetur të tharë, hapja e shtigjeve, ndikon edhe në kujdesin, dhe uljen e rezikut ndaj zjarreve në pyje, si dhe pengimin e përhapjes së sëmundjeve dhe dëmtuesve.

Neni 4

Programi i trajtimit të pyjeve të reja

1. Programi për trajtimin e pyjeve të reja (prerjet kulturore) do të përmbaj disa kritere, duke pasur parasysh përzgjedhjen, rregullimin dhe përpjesëtin e ekzemplarëve të vlefshëm si drurë të së ardhmes;
2. Në kuptimin e gjërë duhet të përmbajë: Pjesën tekstuale, ku përshkruhen gjendja e përgjithshme e terrenit si dhe grumbullit pyjor; Pjesën tabelore\pjesa e matjeve dhe llogaritjes së vëllimit, si dhe; Pjesa hartografike ku parashihen brezat, shtigjet dhe depot e përkohshme.
3. Në kuptimin me të ngushtë programi do të përmbaj kapitujt:
 1. Hyrjen;
 2. Nevojat për trajtim të grumbullit pyjore në këtë sipërfaqe;
1.3.3.Të dhënat e përgjithshme të terrenit në të cilën shtrihen këto ngastra pyjore;
 3. Metodologja e punës\matjes së sipërfaqeve provë;
 4. Metoda për zbatimin e trajtimeve në terren;
 5. Hapja e brezave dhe shtigjeve;
 6. Përcaktimi\llogaritja e vëllimit që rezulton nga prerjet, dhe Rekapitullimin.

Neni 5

Mënyra e bashkëpunimit

1. KGj, APK (DKR e APK-së Pejë) dhe NQ, do të kenë një koordinim të ngushtë gjatë periudhës së realizimit të projektit.
2. Çdo bashkëpunim që nuk është cekur në ketë memorandum, por që është në të mirë të planifikimit, dhe menaxhimit të qëndrueshëm të pyjeve, apo të aktivitetave që do të kryhen në projekt, duhet të bashkëngjitët si aneks i këtij memorandumi..

Neni 6

Zbatimi i Memorandumit të Mirëkuptimit

1. KGj, APK (DKR e APK-së Pejë) dhe NQ do të emërojnë personat kyç për bashkëpunim, koordinim dhe zbatimin e memorandumit. Palët do të angazhohen për të siguruar që personeli i përfshirë në bashkëpunim të jetë me standarde të larta të efikasitetit, kompetencës dhe integritetit.
2. APK përmes, DKR e APK-së Pejë, konform obligimeve dhe detyrave të punës do të hartojo Programin për trajtimin e pyjeve të reja. Do të ofroj trajnim disa ditorë në përgatitje të punëtorëve të terrenit për trajtimin e pyjeve të reja, (në përzgjedhjen e trungeve të ardhmërisë, shpërndarjen uniforme dhe kujdesin në punë). DKR e APK-së Pejë gjithashtu do të jetë në monitorim dhe në mbështetje të projektit.

-
3. Njësia Komunale e Pylltarisë , do të angazhoj një teknik të pylltarisë, i cili do të përcjell në vazhdimësi aktivitetet në pyje, (gjatë kohës së trajtimit të pyjeve) deri në përfundim, si dhe në koordinim me rojën e pyllit i cili do të lëshoj flet përcjellëse për masën drusore që transportohet në ngrrohtore, duke mbajtur evidencë edhe në ditarin e punës, për çdo aktivitet ditor, bazuar edhe në obligimet ligjore për përcjellje të masës drusore.
 4. NjKP, GIZ dhe Ngrohtorja e Qytetit , do të bëjë angazhimin e punëtorëve, transportin, ushqimin, mjetet e punës dhe pajisjet për sigurinë e punëtorëve në punë.

Neni 8

Vlerësimi

1. DKR e APK-së Pejë mund të ndërmarrë një vlerësim, të projektit gjatë ose pas zbatimit të memorandumit, në të cilin do të marrë pjesë edhe NjK e Pylltarisë dhe NQ. Këta të fundit në të gjithë rastet do të ndihmojnë vlerësuesit në punën e tyre, dhe do t'u ofrojnë të shqyrtojnë dokumentet e nevojshme.
2. Pas përfundimit të punimeve , do të bëhet pranim dorëzimi i objektit (sipërfaqes e cila është trajtuar), nga një komision i përbashkët i udhëhequr nga zyrtarët profesional të DKR të APK-së Pejë, me anëtarë nga NjKP dhe nga NQ.

Neni 9

Modifikimi

1. Ndryshimet eventuale në Memorandum do të bëhen pas konsultimit ndërmjet palëve.
2. Ky Memorandum mund të modifikohet, me marrëveshje në mes të palëve.

Neni 10

Komunikimi dhe njoftimi

1. Çdo koment në lidhje me interpretimin ose zbatimin e këtij memorandumi do të shkruhet në gjuhen shqipe, ose edhe në gjuhen angleze.

Neni 11

Nënshkrimi

1. Palët bien dakord të nënshkruajnë Memorandumin në 3 kopje origjinale .
2. Memorandumi do të hyjë në fuqi në datën e nënshkrimit me efekt deri më 31.12.2021.



3. Vazhdimi i bashkëpunimit mund të jetë i mundur, dhe do të kërkonte një aneks shtesë. Palët mund të përfundojnë Memorandumin në çdo kohë, me 4 javë njoftim paraprak me shkrim.

Bekim HOXHA
Agjencia Pyjore e Kosovës



Gjakovë, 22.09.2021

Ardian GJINI
Komuna e Gjakovës

Albana SKIVJANI
Ngrohtorja e Qytetit SH.A. Gjakovë

Gjakovë, 22.09.2021

Gjakovë, 22.09.2021